

'Është e regjistruar te ADN-ja'

Evolucionistët argumentojnë se, duke përdorur gjenetikën, është e mundur të rindërtohet historia evolucionare e një organizmi. Në rastin e specifizimit brenda llojit, është e vërtetë se mund të vëzhgohen rreze të tilla të përsosura të ndryshimeve gjenetike, saqë mund edhe të skicohet rruga e specifizimit, siç është rasti, për shembull, me mizat e frutave (*Drosophila*) që gjenden në Ishujt Havai. Megjithatë, kur pretendime të tilla janë bërë lidhur me evolucionin e një lloji kafshe në një tjetër, rasti është shumë më pak bindës.




Fig. 42 Historia e supozuar evolucionare sipas Akademisë Kombëtare të Shkencave

Kapitulli 7

	Ndryshimi i rendit (%)	Divergjencia e supozuar (miliona vjet më parë)
Vertebrorët / insektet	24-34	600
Peshqit / zvarranikët	16-30	400
Gjitarët / zvarranikët	8-21	300
Zogjtë / zvarranikët	7-20	230

Tabela 1 Ndryshimet e rendit të citokromit C mes llojeve të ndryshme të kafshëve dhe kohës në të cilën supozohet se ato divergjuan nga një paraardhës i përbashkët.

Nga Science and Creationism: A View from the National Academy of Sciences, fq. 19.

Evolucionistët pretendojnë se, duke i krahasuar gjenet e dy organizmave të gjallë të cilët kuptohet se kanë rrjedhur nga një paraardhës i përbashkët miliona vite më parë, është e mundur të matet sasia e evolucionit që ka ndodhur. Kjo mund të bëhet, argumentojnë ata, duke i krahasuar rendet e aminoacideve të proteinat, për shkak se këto pasqyrojnë ndryshimet në gjenet që specifikojnë strukturën e tyre. Në botimet e tyre *Shkenca dhe Kreacionizmi*, Akademia Kombëtare e Shkencave krahason një numër proteinash të gjetur në organizma të ndryshëm. Për shembull, ata i krahasojnë të dhënat e rendit të aminoacideve për proteinën citokrome C që gjendet tek insektet, peshqit, zvarranikët, zogjtë dhe gjitarët (Shih. Fig. 42 dhe Tabelën 1).¹ Meqenëse vertebrorët dhe insektet supozohet se divergjuan nga një paraardhës i përbashkët rreth 600 milionë vjet më parë, zvarranikët dhe peshqit divergjuan afro 400 milionë vjet më parë, ata debatojnë se mund të pritet të shihet një ndryshim më i madh në rendet e citokrome C kur krahasohen vertebrorët me insektet sesa kur krahasohen zvarranikët me peshqit. Në mënyrë të ngjashme, meqenëse gjitarët dhe zvarranikët supozohet se divergjuan afro 300 milionë vjet më parë, mund të pritet të shihet më pak ndryshim në rendet e tyre të citokrome C, sesa kur krahasohen zvarranikët me peshqit. Meqenëse kjo është ajo që është gjetur, teoria argumentohet si e shëndoshë dhe se i ka dhënë shtysë konceptit të *orës molekulare*. Prandaj, pasi është vlerësuar shpejtësia e mutacionit për një proteinë të caktuar, mund të supozohet se llogaritet data e përafërt në të cilën nisën të divergjonin dy organizmat nga paraardhësi i tyre i përbashkët, me anë të krahasimit të rendeve për këtë proteinë. Një argument i ngjashëm u prezantua lidhur me hemoglobinën.

Një vlerësim më kritik i kësaj dëshmie zbulon një pamje tjetër. Hipoteza e orës molekulare merr të mirëqenë një shpejtësi konstante të mutacionit *për njësi të kohës*, por vëzhgimet tregojnë se shpejtësitë e mutacionit me më shumë kuptim do të mateshin *për brez*. Kur dikush merr në konsideratë kohët e ndryshme të riprodhimit për organizmat, teoria është shumë më pak bindëse. Për shembull, proteinat e brejtësve të vegjël, të tillë si minjtë, janë aspak më divergjente nga ato të primatëve, të tillë si elefantët ose balenat, të cilat janë specie që kanë kohë shumë më të gjata riprodhimi.² Kohët e riprodhimit të insekteve mund të variojnë prej afro njëmijë herë, por proteinat e rendeve të ndryshme të insekteve janë njëlloj divergjente nga ato të vertebrorëve.³ Koha e riprodhimit për mizat e frutave, për shembull, është afro dy javë, kurse për gjinkallat është shtatëmbëdhjetë vjet.

Për më tepër, shpejtësia e orës molekulare duket se varion jashtëzakonisht kur studiohet në organizma të ndryshëm dhe në lidhje me proteinat e ndryshme.⁴ Përmjet evolucionare të bazuara në konceptin e orës molekulare ndryshojnë shumë nga ato të prodhuara nga paleontologët që bazohen në të dhënat e fosileve.⁵ Sipas Zigfrid Sherer [Siegfried Scherer], Profesor i Biologjisë Molekulare në Universitetin Teknik, Mynih, 'një orë e besueshme molekulare në lidhje me rendet e proteinave duket sikur nuk ekziston ... Arrihet në përfundimin se hipotezat e orës molekulare duhen kundërshtuar.'⁶ Këto probleme ishin konfirmuar në kohët e fundit nga Mark Farmer, Profesor i Biologjisë Celulare në Universitetin e Georgia: 'Ne, si shkencëtarë, e pranojmë me gatishmëri se përafrimet tona të hershme duke përdorur gjene të ndryshme si ose për një orë të qëndrueshme molekulare, janë ndoshta defektive ... mjaft e thjeshtë, ora molekulare, kur duhet që të nxjerrë këto tipe krahasimesh, shpesh është një model me të meta, dhe nuk funksionon gjithmonë.'⁷

Në lidhje me pritjet e evolucionistëve duke shpresuar të gjejnë te gjenetika provën e pakapshme të evolucionit dhe 'lidhjet që mungojnë', biologu molekular Dr. Majkëll Denton [Michael Denton] komenton,

Prospekti i gjetjes së rendeve në natyrë me anë të kësaj teknike ishte me një interes të madh potencial. Atje ku fosilet kishin dështuar, dhe ku krahasimet morfologjike ishin në më të mirën e tyre vetëm të errëta, ndoshta kjo fushë e re e biokimisë krahasuese mundet më në fund të japë dëshmi objektive të rendit dhe të lidhjeve bashkuese të cilat janë kërkuar për kaq shumë kohë nga biologët evolucionistë. Megjithatë, ndërsa gjithnjë e më shumë rende proteinash nisën të akumuloheshin gjatë viteve 1960të, u bë gjithnjë e më e dukshme se

Kapitulli 7




Fig. 43 a Barazlargësia e citokrome C nga krap

Nga M. O. Dayhoff, Atlas of Protein Sequence and Structure.




Fig. 43 b Barazlargësia e hemoglobinës nga peshku shirit

Nga M. O. Dayhoff, Atlas of Protein Sequence and Structure.

molekulat nuk do të jepnin asnjë dëshmi të marrëveshjeve vijuese në natyrë ... që të gjitha dëshmitë direkte për evolucionin janë prerazi jo të pranishme.⁸

Denton e ngre çështjen e tij duke përdorur të dhëna tabelare në *Atlasin e Rendit dhe Strukturës së Proteinave* të Dayhoff-it.⁹ Për shembull, ai e krahason rendin e citokromit C të një peshku me atë të një amfibi, zvarraniku, zogu dhe gjitari. Ndryshimet variojnë me vetëm 1 për qind, siç shihet në Fig. 43 a, duke treguar se asnjëri nuk është formë ndërmjetëse ose kalimtare për tjetrin. Kjo do të thotë se ndërkohë që rendet variojnë shumë mes llojeve të ndryshme (peshqit, amfibët, zvarranikët, zogjtë dhe gjitarët), ashtu siç tregon botimi i Akademisë Kombëtare të Shkencave, kur secili lloj krahasohet me peshqit, variacioni duket se është i neglizhueshëm. Në mënyrë të ngjashme, ai e krahason rendin e hemoglobinës të një peshku 'primitiv' pa nofulla (peshku shirit) me atë të një peshku 'më të evoluar' (krap), amfibi (bretkosa), zogu (pula), marsupiali (kanguri) dhe plaçentali (njeriu), siç tregohet në Fig. 43 b. Këto ndryshime variojnë me një maksimum prej 8 për qind, me njeriun që del më pranë peshkut 'primitiv'! Denton arrin në përfundimin se 'nuk ka asnjë gjurmë në nivelin molekular të serive tradicionale të evolucionit, peshqit ⇔ amfibët ⇔ zvarranikët ⇔ gjitarët'.¹⁰




Fig. 43 c Barazlargësia e citokrome C nga mola e mëndafshit

Nga M. O. Dayhoff, Atlas of Protein Sequence and Structure.




Fig. 43 d Barazlargësia e citokrome C nga bakteret

Nga M. O. Dayhoff, Atlas of Protein Sequence and Structure.

Prandaj, mund të debatohet qartë se studimet e të dyjave: citokromit C dhe hemoglobinës nuk mbështesin as idenë e orës molekulare, as të besimit se disa organizma janë kalimtare ose më të evoluara se të tjerët. Në fakt, problemi për evolucionistët mund të shihet se është shumë më keq kur konsiderohen rendet e proteinave të organizmave me ndryshime edhe më të mëdha në anatomi, siç shpjegohet nga Dr Karl Uiland [Carl Wieland] nga Creation Ministries International:

... kur krahasoni rendin e aminoacideve në proteinën citokrome C të një mole mëndafshi me atë të së njëjtës proteinë në krijesa shumë të ndryshme nga njëra-tjetra, si kali, pëllumbi, breshka, peshku shirit, krapi, që të gjitha të marra nga libri i Dayhoff-it, *Atlasi i Rendit dhe Strukturës së Proteinave*, ato janë që të gjitha me të njëjtën përqindje difference nga mola e mëndafshit—mes 25 dhe 30 % [Fig. 43c]. Ky model duket se mbizotëron kudo. Distanca nga citokromi bakterial te ai i kalit, pëllumbit, peshkut ton, molës së mëndafshit, mykut, grurit përsëri është i njëjtë, 64-69 % [Fig. 43d]. Nga ana tjetër, citokromi C i kalit është pothuajse me të njëjtën distancë nga të gjithë të tjerët. Çdo krijesë duket sikur është me të njëjtën largësi nga krijesat e tjera mbi këtë bazë. Natyrisht ne po krahasojmë bakteret e sotme me kalin e sotëm dhe koha prej të njëjtit paraardhës të supozuar të përbashkët do të ketë qenë e njëjtë. Kështu që evolucionistët janë përpjekur ta sqarojnë plotësisht

Kapitulli 7

këtë model të papritur duke thënë se ora molekulare rreh me të njëjtin ritëm për të gjitha krijesat ... por që të gjitha ato kanë kohë riprodhimi shumë të ndryshme. Në njëmijë vjet, bakteret pësojnë riprodhim shumë më të madh se sa kuajt, dhe le të themi, ka gjithashtu mundësi të tjera të panumërta për të kopjuar gabimet, bakteret aktualisht njihen se kanë shumë më tepër mutacione për një brez. Kjo duket se sugjeron se shumica e ndryshimeve të rendeve nuk erdhi prej mutacionit dhe se i tërë modeli i përshtatet ndarjes së grupeve kryesore të kafshëve që kur u krijuan te Zanafilla.¹¹

Komenti i fundit i Dr. Uiland është tejet i rëndësishëm. Kudo nëpër natyrë, proteinat shfaqin një model shumë të rregullt të diversitetit, me secilën klasë organizmash të izoluar, të dallueshme dhe të palidhur me forma kalimtare. Kjo nuk reflekton parashikimet e teorisë evolucionare, por modelin biblik – se Perëndia i krijoi organizmat e ndryshëm sipas llojeve të tyre, të cilat gjithnjë kanë qenë grupe të veçara dhe të palidhura.¹²

Shënimet

- 1 *Science and Creationism, A View from the National Academy of Sciences* (2nd edn.; Washington DC: National Academy Press, 2002), fq. 19.
- 2 **Michael Denton**, *Evolution: A Theory in Crisis* (Bethesda, MD: Adler & Adler, 1986), fq. 297.
- 3 Po aty. fq. 298.
- 4 **Siegfried Scherer**, 'The Protein Molecular Clock: Time for a Re-evaluation', *Evolutionary Biology*, 24 (1990), fq. 83–105.
- 5 **Ernst Mayr**, *The Growth of Biological Thought: Diversity, Evolution and Inheritance* (Cambridge, MA: Belknap Press, 1982), fq. 577.
- 6 **Scherer**, 'The Protein Molecular Clock'.
- 7 [Konflikti mbi origjinën] Clash Over Origins, debati mes Dr Carl Wieland dhe Dr Mark Farmer ne Worldview Superconference, Asheville, NC, 2006. (DVD merret nga Creation Ministries International, Australia.)
- 8 **Denton**, *Evolution: A Theory in Crisis*, fq. 277–278.
- 9 **Margaret O. Dayhoff**, *Atlas of Protein Sequence and Structure* (Silver Spring, MD: National Biomedical Research Foundation, 1972).
- 10 **Denton**, *Evolution: A Theory in Crisis*, fq. 284.
- 11 *Clash Over Origins*.
- 12 **Denton**, *Evolution: A Theory in Crisis*, Kap. 13.